



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

01 Nr. 16-5627/15
Kaçanik, 27.02.2015

Në bazë të nenit 57.1 dhe 57.2 të Rregullorës për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Raportit të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2014, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 27.02.2015, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE
FINANCA PËR VITIN 2014

I.

Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 16- 5627/2015, më tekstin e mëtejshëm, “Raporti i Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2014”, i hartuar nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

II.

Raporti si në pikën I. të këtij Vendimi, përmban pikësyzimet në lidhje me realizimin e detyrave nga fushëveprimtaritë që janë në kompetencë të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe nivelin e realizimit të tyre, për aktivitetin e zhvilluar për gjatë vitit 2014.

III.

Raporti i KPF është i përmbledhur në gjithsej 8 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

IV.

Me këtë Vendim njoftohet: Komiteti për Politikë dhe Financa, Kryetari i Komunës dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi